



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 478/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, për shkak të vendosjes së panos në ndërtësë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog në të cilën pretendohet se me datën 30.10.2013, subjekti politik AAK, dega në Istog ka pasur tubim politik të lajmëruar për në orën 16:00 në oborrin e Pallatit të Kulturës "A Jashari". Rreth orës 10:00, aktivistë të këtij subjekti kanë hipur në pullazin e këtij pallati dhe kanë vendosur në pano të madhe me foton e kandidates për kryetare të komunës Donika Kadaj Bujupi, ku me këtë rast kanë mbuluar të gjitha dritaret e zyrës së KKZ-së që ndodhet në këtë pallat, kati i dytë. Parashtuesi i ankesës thekson se pas shumë vërejtjeve për të larguar këtë pano , ajo nuk u largua deri të nesërmen në mëngjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.11.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se vendosja e panos së kandidates së AAK-së, për kryetare në Istog Donika Kada në ballë të bibliotekës ka qenë i lajmëruar edhe në KKZ lokale, e po ashtu edhe tubimi ka qenë i lajmëruar. Më tutje theksohet se për arsy që tubimi është mbajtur në ambient të hapur dhe vendosja e këtij posteri ka qëndruar vetëm në kohën para dhe deri sa ka përfunduar tubimi përmbyllës, me të përfunduar tubimi është bërë heqja e të gjitha materialeve reklamuese politike, nga vendi ku është mbajtur tubimi. AAK konfirmon që me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar struktura menaxhuese të fushatës të cilët kanë konfirmuar largimin e materialeve reklamuese pas tubimit. Bashkangjitur përgjigjes në ankesë

janë provat si: Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së, drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së, për respektimin e ligjit mbi zgjedhjet dhe rregulloreve të KQZ-së, fotografi në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të panos, kërkesën drejtuar shefave të shtabeve zgjedhore për respektim të Kodit Zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e bashkangjitur si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se pano e kandidates për kryetare të komunës së Istogut Donika Kadaj – Bujupi është e vendosur në ndërtesë publike, që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se, subjekti politik AAK, ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se pano e kandidates të AAK-së, për kryetare të komunës, ka qenë e vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e panove dhe po ashtu subjekti politik në fjalë shkeljen e të njëjtës natyre e ka përsëritur edhe më parë në këto zgjedhje. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim të shkeljes, duke e larguar panon nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i, konstatoi se subjekti politik AAK, ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga fotografia e cila gjendet në shkresat e lëndës identifikohet qartë se pano e kandidates së AAK-së, për kryetare të komunës së Istogut, është e vendosur në ndërtesë publike, që është e ndaluar me dispozitat ligjore te sipershënuar siç theksohet edhe në ankesë.

Për lartësinë e gjobës së shqiptuar PZAP-i mori parasysh veprimet e menjëherershme të subjektit politik AAK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar, veprime të cilat subjekti politik në fjalë i ka mbështetur me fotografi si dëshmi nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar, si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura ne përgjigje te ankesës andaj në kuptim te nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa në Prishtinë**

Anr. 478/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkasat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetkatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i. në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*